



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kuvendi**

**PROJEKT LIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2022

**PËR**

**IDENTIFIKIMIN E PRONARËVE PËRFITUES TË PARTNERËVE NË**  
**SEKTORIN PUBLIK**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti**

Ky ligj përcakton rregulla dhe kriteret të qarta për ndalimin e operatorëve ekonomikë për të cilët nuk është i mundur identifikimi real i pronarëve përfitues, që të krijojnë marrëdhënie juridike dhe tregtare me autoritetet dhe entet shtetërore, që kanë për objekt përfitimin e fondeve, pasurive apo të mirave publike.

**Neni 2**  
**Qëllimi**

Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë transparencën në proceset e prokurimit publik, kontratave koncesionare, partneritetit privat publik / PPP, investimeve strategjike, kontratave për dhënie në përdorim, shitje apo çfarëdolloj forme tjetër cedimi, tjetërsimi apo kalimi të pasurive të paluajtshme publike nga institucionet shtetërore, agjencitë, entet apo kompanitë me kapital shtetëror;

- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të mirëadministrojë pasuritë publike;
- c) të ndalojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë për të cilët nuk është i mundur identifikimi i pronarëve përfitues;
- ç) të ndalojë përfitimin e fondeve dhe pasurive publike nga deputetët, zyrtarët, personat e lidhur me ta apo dhe të personave që janë të dënuar penalisht;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në administrimin e pasurisë publike;
- e) të përcaktojë sanksionet përkatëse në rast të shkeljeve të detyrimeve të parashikuara na këtë ligj.

### Neni 3 Fushat e Zbatimit

1. Ky ligj zbatohet ndaj personave juridikë të mëposhtëm, pavarësisht nëse janë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë apo dhe jashtë saj, të cilët sipas këtij ligji konsiderohen Partnerë në Sektorin Publik :

- a) shoqëritë më përgjegjësi të kufizuar;
- b) shoqëritë aksionare;
- c) shoqëritë kolektive;
- ç) shoqëritë komandite;
- d) zyrat e përfaqësimit dhe degët e shoqërive të huaja;
- dh) shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre;
- e) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;
- ë) shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor;
- f) çdo subjekt/entitet tjetër juridik;
- g) organizatat jofitimprurëse, ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja, të regjistruara në regjistrin e organizatave jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë apo dhe jashtë territorit të saj;
- gj) personat juridikë dhe ndërmarrjet, aksionarët e të cilëve, përveç institucioneve qendrore dhe/ose vendore të Republikës së Shqipërisë, janë edhe individë/persona juridikë të tjerë shqiptarë dhe/ose të huaj.

2. Ky ligj nuk zbatohet për:

- a) personat fizikë, tregtarë të regjistruar në regjistrin tregtar;
- b) personat juridikë dhe ndërmarrjet, aksionari i vetëm i të cilëve janë institucionet qendrore dhe/ose vendore të Republikës së Shqipërisë apo institucione qendrore dhe/ose vendore të shteteve të tjera apo të organizmave ndërkombëtare;
- c) bashkësitë fetare;
- ç) partitë politike;
- d) shoqëritë e kuotuar në bursa;
- e) bankat e nivelit të dytë.

3. Ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike me vlerë më të ulët se 5.000.000 (pesë milion) lekë.

## Neni 4 Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

1. **“Partner në Sektorin Publik”**, për qëllime të këtij ligji një Partner në Sektorin Publik, përveç përjashtimeve të parashikuara shprehimisht në nenin 3, pika 2, do të konsiderohet çdo person fizik apo juridik, si dhe çdolloj organizate joftimprirurëse që:

- a) përfiton fonde nga buxheti i Shtetit, nga buxheti i një entit shtetëror, nga buxheti i një shoqërie tregtare me pjesëmarrje të shtetit, nga buxheti i institucioneve publike, nga buxheti i organeve të qeverisjes vendore, nga buxheti i çdo fondi investimesh publik, nga çdolloj buxheti që administrohet nga organizma apo agjenci shtetërore;
- b) përfiton një shërbim apo një të drejtë e cila ka për objekt pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, në pronësi apo administrim të Shtetit, të një institucioni publik, të organeve të qeverisjes vendore, të shoqërive tregtare me pjesëmarrje të shtetit;
- c) ka lidhur një kontratë, marrëveshje, kontratë konçesioni apo partneriteti publik privat / PPP, sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm në fuqi;
- d) ka përfituar statuse të posaçme dhe të privileguara, në sektorët strategjikë, si investim/investitor strategjik apo që përfiton shërbime dhe asistencë nga organe, institucione, agjenci apo ente publike, sipas akteve ligjore apo nënligjore të posaçme në fuqi;
- e) drejtpërdrejt apo jodrejtpërdrejt, ofron çdolloj shërbimi apo furnizon me produkte, subjektet e përcaktuara në gërmat a), b), c) dhe d), dhe në të njëjtën kohë është në dijeni ose duhet të jetë në dijeni, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat, që shërbimi apo furnizimi që po kryen, janë të lidhura drejtpërdrejt me një kontratë sipas përkufizimit të pikës 5.

2. **“Pronar përfitues”**, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar.

3. **“Pronësi direkte”**, për efekte dhe qëllime të këtij ligji është pronësia e mbajtur nga një individ, në çfarëdolloj mase qoftë ajo, të aksioneve/kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një Partner në Sektorin Publik.

4. **“Pronësi indirekte”** është pronësia e mbajtur ose kontroll i ushtruar nga i njëjti individ në një ose më shumë persona juridikë, të cilët veçmas ose së bashku zotërojnë aksione/kuota të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një Partner në Sektorin Publik.

5. **“Kontratë Publike”** është kontrata, marrëveshja, konçensioni, Partneriteti Publik Privat/PPP apo çdo akt/veprim juridik, në bazë të së cilës Partneri në Sektorin Publik përfiton fonde publike, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme shtetërore, të

drejta pronësie apo të drejta të tjera reale, mbi pasuri të paluajtshme në pronësi dhe administrim të organeve shtetërore, apo dhe statutet e investimit/investitorit strategjik.

6. **“Vlera e kontratës”** është vlera monetare e përcaktuar në kontratën publike apo/dhe përfitimi total i realizuar në terma ekonomike nga Partneri në Sektorin Publik.

7. **“Të dhëna zyrtare”** janë faktet që përmbahen në aktet dhe dokumente zyrtare, të konfirmuara nga një subjekt apo organ kompetent sipas legjislacionit të vendit ku figuron i regjistruar subjekti, të cilat identifikojnë në mënyrë të pakontestueshme pronarët përfitues të Partnerëve në Sektorin Publik.

8. **“Subjekt Raportues”** për qëllime të këtij ligji është:

a) **“Subjekt Raportues Vendas”** është personi juridik i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 2 të ligjit nr. 112/2020 “Për regjistrin e Pronarëve Përfitues”, i cili ka interes për të marrë pjesë në një procedurë ligjore për përfitimin e fondeve, pasurive, pronave, aseteve apo të mirave publike, dhe që ka detyrimin ligjor të regjistrojë pronarët përfitues në Regjistrin e Pronarëve Përfitues.

b) **“Subjekt Raportues i Huaj”** është personi juridik i regjistruar rregullisht jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili ka interes për të marrë pjesë në një procedurë ligjore për përfitimin e fondeve, pasurive, pronave, aseteve apo të mirave publike dhe që ka detyrimin ligjor të regjistrojë pronarët përfitues në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, sipas këtij ligji.

9. **“Autoritetet Përgjegjëse”** janë të gjitha organet, institucionet, agjencitë, entet shtetërore, të cilat janë në një marrëdhënie juridike me një Partner të Sektorit Publik.

10. **“Autoritetet e Kontrollit”** janë:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- b) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- c) Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare;
- d) Policia e Shtetit;
- e) Prokuroria;
- f) Qendra Kombëtare e Biznesit;
- g) Agjencia e Prokurimeve Publike;
- h) Ministria Përgjegjëse për Ekonominë;
- i) Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve;
- j) Komiteti i Investimeve Strategjike.

11. **“Ankim i kualifikuar”** është ankimi i paraqitur pranë autoriteteve përgjegjëse apo të kontrollit, nga çdo person, i cili është i arsyetuar dhe bazuar mbi rrethana apo fakte të qenësishme dhe që në pamje të parë lejojnë fillimin e një procedure administrative.

## **Neni 5**

### **Parimi i transparencës**

1. Kontratat publike duhet t'i nënshtrohen një procesi përzgjedhjeje të Partnerit në Sektorin Publik, duke mundësuar identifikimin real të çdo individi, bazuar në akte apo dokumente zyrtare, të konfirmuara nga organet kompetente, që zotëron, në çfarëdo lloji mase, aksione/kuota të kapitalit ose interesa të tjerë, në personin juridik i cili do të përfitojë nga fondet apo pasuria publike.

2. Asnjë subjekt apo entitet juridik, përveç përjashtimeve të parashikuara në pikën 2, të nenit 3 të këtij ligji, nuk mund të përfitojë statusin e Partnerit në Sektorin Publik apo mund ta humbasë atë në çdo moment, nëse nuk ka identifikuar paraprakisht pronarët përfitues apo nëse nuk ka përditësuar të dhënat për pronarët përfitues sipas përcaktimeve të nenit 7, të këtij ligji.

## **KREU II**

### **DETYRIMET E SUBJEKTEVE REPORTUESE DHE KONTROLLI I TË DHËNAVE**

#### **Neni 6**

#### **Detyrimet e subjekteve raportuese për identifikimin paraprak të pronarëve përfitues**

1. Subjektet raportuese vendase, që kanë interes për tu bërë Partner në Sektorin Publik, kanë detyrimin që përpara se të marrin pjesë në procedurat e parashikuara në legjislacionin përkatës për përfitimin e fondeve dhe të mirave publike, të regjistrojnë në regjistrin e pronarëve përfitues, të gjithë pronarët përfitues, pavarësisht masës që zotërojnë ata, duke përcaktuar saktësisht llojin dhe masën e kontrollit në subjektin juridik.

2. Pas regjistrimit në regjistrin e pronarëve përfitues, subjekti raportues vendas, ka të drejtë të përfitojë një kontratë publike. Regjistrimi i të dhënave të subjekteve raportuese vendase bëhet sipas parashikimeve të ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues.

3. Subjektet raportuese të huaja, që kanë interes për tu bërë Partner në Sektorin Publik, kanë detyrimin që të dorëzojnë pranë autoriteteve përgjegjëse kompetente, për zhvillimin e procedurave të parashikuara në legjislacionin përkatës për përfitimin e fondeve dhe të mirave publike, të gjithë dokumentacionin tekniko – ligjor, për të identifikuar të gjithë pronarët përfitues, pavarësisht masës që zotërojnë ata, duke përcaktuar saktësisht llojin dhe masën e kontrollit në subjektin juridik, si dhe çdo të dhënë që përcaktohet në ligjin për regjistrin e pronarëve përfitues.

4. Të dhënat e subjekteve raportuese të huaja, nuk regjistrohen në ndonjë regjistër të posaçëm, por ato administrohen dhe bëhen publike nga autoritetet përgjegjëse. Për këto subjekte, për sa është e aplikueshme, zbatohen dispozitat ligjore që rregullojnë regjistrin e pronarëve përfitues.

5. Identifikimi apo regjistrimi i të gjithë pronarëve përfitues, i subjekteve raportuese, sipas parashikimeve të këtij ligji, duhet të bëhet vetëm bazuar mbi të dhëna zyrtare të konfirmuara nga një subjekt apo organ kompetent sipas legjislacionit të vendit ku figuron i regjistruar subjekti, të cilat identifikojnë në mënyrë të pakontestueshme pronarët përfitues të subjekteve raportuese.

6. Për qëllime të këtij ligji, pronarët përfitues të Partnerëve në Sektorin Publik apo subjekteve raportuese, nuk mund të identifikohen bazuar mbi fakte deklarative apo në akte dhe fakte të tjera, që nuk janë të konfirmuara nga organe kompetente, sipas përcaktimeve të pikës 5, të këtij neni.

7. Në rast se subjektet raportuese, nuk mund të identifikojnë të gjithë pronarët e tyre përfitues, llojin dhe masën e kontrollit për secilin, bazur në të dhëna zyrtare, ata nuk mund të përfitojnë asnjë kontratë publike, duke u skualifikuar nga çdo lloj procedure të parashikuar sipas përcaktimeve në legjislacionin e posaçëm.

8. Të dhënat e pronarëve përfitues, të publikuara në regjistrin e pronarëve përfitues, duhet të jenë të regjistruara, minimalisht për periudhën e përcaktuar në kontratën publike ose deri në datën kur Partneri në Sektorin Publik do të përfitojë nga fondet apo të mirat publike, sipas kontratës përkatëse.

## **Neni 7**

### **Përditësimi i të dhënave**

1. Partnerët në Sektorin Publik, që kanë përfituar një kontratë publike, gjatë afatit të zbatimit apo efekteve të saj, kanë detyrimin që të përditësojnë të dhënat e pronarëve përfitues, brenda 20 – ditëve kalendarike nga dita kur këto të dhëna kanë ndryshuar.

2. Përditësimi i të dhënave për subjektet vendase duhet të kryhet në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm. Subjektet e huaja, të cilat nuk mund të kryejnë përditësimin në këtë regjistër, duhet ti komunikojnë të dhënat e përditësuara, pranë autoriteteve përgjegjëse.

3. Çdo lloj përditësimi i të dhënave për identifikimin e pronarëve përfitues, duhet të kryhet bazuar në të dhëna zyrtare.

4. Partnerët në Sektorin Publik kanë detyrimin, nëse kanë një kontratë publike aktive, që nëpërmjet personave të autorizuar prej tyre, të komunikojnë çdo fillim viti, brenda datës 31 janar në regjistrin e pronarëve përfitues apo pranë autoriteteve përgjegjëse, sipas rastit, pronarët përfitues efektivë që rezultojnë të tillë në datën 31 dhjetor të vitit të sapo mbyllur.

## **Neni 8**

### **Verifikimi i të dhënave**

1. Autoritetet përgjegjëse apo ato të kontrollit, mund të verifikojnë të dhënat e regjistruara në regjistrin e pronarëve përfitues apo të komunikuar nga subjektet e huaja, me iniciativën e tyre ose mbi bazën e një ankimi të kualifikuar, në lidhje me faktin nëse të dhënat e komunikuar janë të vërteta dhe të plota.

2. Një ankim i kualifikuar mund të paraqitet nga kushdo. Ankimi i kualifikuar duhet të përmbajë, përveç të dhënave të përgjithshme dhe paraqitjen e rrethanave apo të fakteve që kontestohen, që të justifikojnë një dyshim të arsyeshëm mbi vërtetësinë apo saktësinë e të dhënave të paraqitura nga subjektet raportuese apo Partneri në Sektorin Publik. Një ankim, i cili nuk mund të konsiderohet i kualifikuar, nuk mund të merret parasysh nga autoriteti dhe ky fakt i duhet komunikuar ankuesit.

3. Në rastin e fillimit të një procedimi administrativ për verifikimin e të dhënave do të zbatohen përcaktimet ligjore të Kodit të Procedurave Administrative. Në rast se Partneri në Sektorin Publik nuk provon në mënyrë të besueshme që të dhënat e komunikuar apo të regjistruara nuk janë të vërteta apo të plota, autoriteti mund të procedojë duke aplikuar sanksionet e parashikuara në nenin 9 apo 10 të këtij ligji.

## **KREU III**

### **KUNDRAVAJTJET DHE RASTET E SKUALIFIKIMIT APO ZGJIDHJES SË KONTRATËS PUBLIKE**

## **Neni 9**

### **Kundërvajtjet administrative**

1. Subjektet raportuese, Partnerët në Sektorin Publik dhe çdo person i autorizuar prej tyre, mbajnë përgjegjësi ligjore, sipas përcaktimeve të legjislacionit penal, për vërtetësinë e të dhënave zyrtare dhe të dokumenteve të komunikuar apo dorëzuara.

2. Shkeljet e mëposhtme, përveç parashikimeve të legjislacionit penal apo penaliteteve të tjera të parashikuara në ligj, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) mos përditësimi i të dhënave brenda afatit të përcaktuar në pikën 1, të nenit 7 të këtij ligji, për subjektet tregtare, dënohet me gjobë, në masën 10% të vlerës së kontratës publike;

b) mos deklarimi i të dhënave brenda afatit të përcaktuar në pikën 4, të nenit 7 të këtij ligji dënohet me gjobë, në masën 10% të vlerës së kontratës publike.

3. Gjoha vendoset nga titullari i autoritetit përgjegjës, me vendim të arsyetuar, i cili mund të ankimohet drejtpërdrejtë në gjykatën administrative kompetente në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe Ligjin Nr. 49/2012 “Për

gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

4. Partneri në Sektorin Publik, të cilit i është vendosur një gjobë, sipas përcaktimeve të këtij neni, nuk mund të përfitojë asnjë kontratë publike tjetër, deri sa gjoba të jetë ekzekutuar sipas legjislacionit në fuqi, përveç rastit kur me vendim të gjykatës së formës së prerë vendimi për dënimin me gjobë është shfuqizuar apo konstatuar absolutisht i pavlefshëm.

### **Neni 10**

#### **Skualifikimi dhe zgjidhja e kontratës publike**

1. Autoritetit përgjegjës, përveç kundravajtjeve të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, në rastin kur subjektet raportuese, sipas këtij ligji, refuzojnë të deklarojnë apo komunikojnë të dhënat zyrtare për identifikimin e pronarëve përfitues, apo provohet që kanë deklaruar të dhëna të rreme dhe jo të plota, i lind e drejta të skualifikojë apo të përjashtojë në çdo moment nga çdo lloj procesi subjektin raportues, duke mos nënshkruar kontratën publike.

2. Autoritetit përgjegjës, përveç kundravajtjeve të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, në rastin kur provohet se Partneri në Sektorin Publik, sipas këtij ligji, ka deklaruar të dhëna të rreme dhe jo të plota, i lind e drejta të zgjidhë në mënyrë të njëanshme dhe të menjëhershme kontratën publike, si dhe sipas rastit të kërkojë dhe shpërblimin e dëmit apo fitimin e munguar, sipas përcaktimeve të legjislacionit civil.

### **KREU IV**

#### **DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 11**

#### **Dispozita të fundit dhe kalimtare**

1. Këshilli i Ministrave përcakton mënyrën e evidentimit në regjistrin e pronarëve përfitues apo lëshimin e ekstrakteve, të subjekteve raportuese apo Partnerëve në Sektorin Publik vendas.

2. Rregullat dhe procedurat për mënyrën e publikimit të të dhënave nga autoritet përgjegjëse, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 6, të këtij ligji, miratohen me udhëzim nga Këshilli i Ministrave.

3. Partnerët në Sektorin Publik ekzistues, që kanë përfituar një kontratë publike, e cila i shtrin efektet e saj apo ka një afat zbatueshmërie për një periudhë më të gjatë se 2 – muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, kanë detyrimin që të komunikojnë dhe përditësojnë të dhënat zyrtare për identifikimin e pronarëve përfitues, sipas përcaktimeve të këtij ligji, brenda 30-ditëve nga hyrja në fuqi e tij. Në rastin kur këto



subjekte, nuk komunikojnë të dhënat zyrtare për identifikimin e pronarëve përfitues brenda afatit të përcaktuar më sipër, dënohen me gjobë me 10% të vlerës së Kontratës Publike.

**Neni 12**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

[SHQIPTARJA.COM]